



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dispozitave të Rregullores Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149, nenit 4 dhe 15 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të punës

Pozita:	Zyrtar i lartë Ekzekutiv
Referenca:	ZLE/ZKA/14-07/17
Koeficienti:	8
Numri i pozitave:	1 (një)
Kohëzgjatja:	Pozitë e karrierës
I përgjigjet:	Udhëheqësit të Kabinetit
Vendi:	Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Mbështetja profesionale për Auditorin e Përgjithshëm për organizim dhe koordinimin e aktiviteteve për realizimin dhe përmbushjen e përgjegjësi të tij.

Zyrtar i lartë Ekzekutiv është përgjegjës për:

1. Ndhmon në organizimin e punës dhe menaxhimin efikas të aktiviteteve të përditshme të kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm dhe ndërlihdjen e departamenteve dhe njësi të tjera organizative të ZKA-së me kabinetin e AP-së;
2. Ofron këshilla profesionale dhe ndihmon realizimin e agjendës së punës për Udhëheqësin e Kabinetit në zhvillimin dhe arritjen e objektivave të punës;
3. Harton shkresa, vendime, udhëzime dhe akte tjera për Kabinetin e Auditorit të Përgjithshëm;
4. Bashkëpunon me udhëheqësit e divizioneve, departamenteve, dhe njësi të tjera të ZKA-së sipas udhëzimeve të Auditorit të Përgjithshëm lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të tyre;
5. Merr pjesë në mbledhjet e ndryshme të Auditorit të Përgjithshëm, mban shënime dhe harton procesverbale sipas nevojës;
6. Siguron klasifikimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve në Kabinetin e Auditorit të Përgjithshëm;
7. Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet organizative dhe çështjeve që kërkojnë shqyrtim nga Auditori Përgjithshëm;

8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Fakulteti juridik, administratë publike ose ekonomik;
- Tri vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën hartimit mbikëqyrjes së zbatimit të politikave dhe ligjshmërisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, e dëshirueshme;

Procedura e Konkurrimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse. Zyra Kombëtare e Auditimit mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, te të gjitha komuniteteve.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: <http://www.zka-rks.org/>

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: rekrutimi@oagks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Zyrën Kombëtare të Auditimit, në rrugën “Musine Kokalari” nr. 87, prej orës 08:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025 dhe 038/606-004, ext:1011. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit, nuk do të pranohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni për Burime Njerëzore.